



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:092041
Datë: 31.01.2022
Numri i dokumentit: 02663150

PPP.nr.1000/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA MALISHEVË Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit F. K. me nr. personal ..., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Bestar Kolgeci, avokat në Prizren, rruga “De Rada”, nr.04, kundër debitorit Komuna e M. – Drejtoria Komunale e Arsimit D., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.3375/2020, i datës 07.12.2020, i caktuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Enis Hoxha , me seli në Prizren, jashtë seancës, me dt. 31.01.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET në tërësi si i **pabazuar** prapësimi i debitorit Komuna e M., Ushtruar nga Avokati Publik i Komunës, i paraqitur kundër urdhrit përmbarimor P.nr.3375/2020, datës 07.12.2020, të Përmbaruesit Privat Privat Enis Hoxha, nga Prizreni, me të cilin është lejuar përmbarimi në këtë çështje juridike të përmbarimit.

II. MBETET në fuqi urdhri P.nr.3375/2020, i datës 07.12.2020, i përmbaruesit privat Enis Hoxha, nga Prizreni, për lejin e përmbarimit në këtë çështje përmbarimore për detyrimin e debitorit në shumën prej 236.61 euro ndaj kreditorit.

A r s y e t i m

Përmbaruesit Privat , Enis Hoxha, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit parashtruar me datë 07.12.2020, nga përfaqësuesi autorizuar Av. Bestar Kolgeci, ka caktuar urdhrin për përmbarim në bazë të dokumentit përmbarimor - Vendimi i Inspektoratit të Punës nr.1352/2019, datë 23.12.2019, i cili është dokument përmbarimor dhe paraqet bazë për lejin e përmbarimit sipas nenit 21 dhe 22 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit ë Procedurës Përmbarimore (tutje LPP).

Kundër urdhrit për lejin e përmbarimit, brenda afatit ligjor me datë 23.12.2020, prapësim ka paraqitur debitori - Avokati Publik Komunal i Komunës së M., në të cilin ka parashtruar se i konteston shumat e borxhit si dhe shpenzimet procedurale, duke kontestuar vendimin e Inspektoratit të punës sepse i njëjti është lëshuar pa u vërtetuar gjendja faktike, pasi që kontrata kolektive janë në fuqi prej vitit 2015 dhe 2017 andaj në 10 vjetshin e parë nuk ishte në fuqi

kontrata dhe kemi të bëjmë me parashkrim të jubilaes së parë, në vazhdim ka kontestuar dhe legjitimitetin e palës për iniciimin e procedurës përmbarimore, pasi që propozimi dhe në urdhër për përmbarim nuk dëshmohet që zyra e Avokatit që përfaqëson ka legjitimitet, pasi që kjo është dëshmuar vetëm me autorizim kopje në shkresat e lëndës dhe jo në origjinale siç e përcakton LPP-ja, duke theksuar se me këtë raste nuk kemi të bëjmë me procedurë përmbarimore sipas dispozitave të LPP –së neni 29, pasi që kontrata nuk është dokument i përmbarueshëm dhe sipas saj neni 13 zgjidhjet e mosmarrëveshjeve bëhen në procedurë Gjyqësore, në afate prej 30 ditësh dhe kemi të bëjmë me marrëdhënie të punës, duke i propozuar Gjykatës që Urdhrin për përmbarim ta anuloj si të pa bazuar ose të hapë seancë këshillore, dhe ti refuzoj shpenzimet përmbarimore.

Kreditori përmes të autorizuarit të tij, brenda afatit ligjor më datën 19.04.2021, ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, në të cilin ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke theksuar se në procedurë përmbarimore vetëm shikohet se a është vendimi i plotfuqishëm dhe i përmbarueshëm, e nëse pala debitorë konsideron që Inspektorati është organ jo kompetente për ta nxjerrë një vendim të tillë atëherë ndaj të njëjtit duhet hapur konflikt administrativ, ndërsa Gjykata përmbarimore nuk mund të lëshohet në ate se a është kompetent Inspektorati për nxjerrë një vendim të tillë apo jo, posë tjerash i ka propozuar Gjykatës që ta refuzojë në tërësi prapësimin e palës debitorë ndërsa Urdhrin përmbarimore ta lerë në fuqi.

Përmbaruesi privat duke vepruar më tej në këtë çështje juridike të përmbarimit, me aktin përcjellës të datës 21.04.2021, kësaj gjykate si organ kompetent i përmbarimit për vendosjen për prapsim ia ka dorëzuar shkresat e lëndës për të vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori i përmbarimit kundër këtij Urdhri për përmbarim.

Gjykata e shqyrtoi lëndën në tersi dhe gjeti se propozimi I kreditorit për përmbarim në bazë të nenit 22 parag.1 pika 2 të LPP paraqet titull përmbarimor në bazë të dokumentit përmbarues konkretisht vendimin Administrativ – Vendimin e Inspektoratit të Punës nr.1352/2019, datë 23.12.2019, dhe i njëjti është në origjinal, është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm nga data 13.01.2020, andaj si i tillë nga përmbaruesi privat me Urdhër është lejuar përmbarimi ndaj të cilit debitorët në afat ligjor parashtrojnë prapësim.

Njëkohësisht bazuar në shkresat e lëndë gjykata vlerësoi se është në kompetencë të saj të vendos për prapësimin duke u mbështetur në dispozitën e nenit 5 parag.5 të LPP-së, gjithashtu pas këtij vlerësimi bazuar në nenin 73 parag.1 të LPP-së erdhi në përfundim se për prapësim mund të vendos jashtë shqyrtimit gjyqësor.

Në shqyrtimin e mëtejme të këtij prapësimi dhe paraprakisht duke e bërë shikimin në shkresat e lëndës së përmbarimit, Gjykata erdhi në përfundim se prapësimi i debitorit ndaj urdhrin P.nr.3375/2020, i datës 07.12.2020, të përmbaruesit Privat që ka të bëjë me Vendimin e Inspektoratit të Punës nr.1352/2019, datë 23.12.2019, është i pa bazuar, për faktin se në kundërshtim nuk janë dhënë arsye që të pranohet kundërshtimi i debitorit dhe atë bazuar në nenin 71 të LPP-së, ndërsa nuk e shfuqizoi Urdhrin e Përmbaruesit Privat P.nr.3375/2020, i datës 07.12.2020, pasi që i njëjti është i mbështetur përkatësisht i lejuar në bazë të titullit përmbarimorë – vendimit të Inspektoratit të Punës në Prizren, nr.1352/2019, datë 23.12.2019, i formës se prerë dhe i ekzekutueshëm nga data 13.01.2020, është në origjinal dhe i njëjti i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili thotë : *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i*

përmbarrimit dhe debitorit, adresa e vendbanimit– vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarrimi, objekti i përmbarrimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit”, sipas nenit 21 të LPP-së i cili thotë : “Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”, sipas nenit 22 par. 1., pika 1.2., ku thotë Dokumente përmbarruese janë: “vendimi përmbarrues i dhënë në procedurë administrative dhe aktapajtimi (më tej: ujdia);”, sipas nenit 23. par.2., i cili thotë “Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse aktapajtim administrativ konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër”, neni 24 par. 3., i cili thotë “Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarrimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”, neni 27 par.1. „Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitorit, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Njëkohësisht, Gjykata pas shqyrtimit të Vendimit të Inspektoratit të Punës nr. nr.1352/2019, datë 23.12.2019, konstaton (siç u cek më lart) se i njëjti është në origjinal, është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm nga data 13.01.2020, andaj edhe vlerëson se ky vendim i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përmbarrues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 21, 22 par.1 pika 1.2, 23 par.2, 24 paragrafi 3 dhe 27 të LPP-së, për të qenë i pambarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarrim, siç u theksua edhe më lart, prandaj me të drejtë mbi bazën e të njëjtit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin.

Prandaj pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë si të arsyeshme sepse prapësimi nuk ja ka bashkëngjitur as edhe një provë të vetme me shkrim, e sipas nenit 69 par. 4 i cili thotë: “Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”, kështu që gjykata një deklaram të tillë të debitorit nuk e aprovoi, pasi që kemi të bëjmë me Vendim administrativë i cili është titull ekzekutiv i bashkangjitura propozimit për përmbarrim, i cili i plotëson të gjitha kushte e parapara sipas nenit 22 par. 1., pika 1.2., të LPP-së dhe njëkohësisht nga shkresat e lëndës rezulton se caktimi i përmbarrimit është bërë duke u bazuar në Vendimin e Inspektoratit të Punës nr.1338/2019, datë 23.12.2019, me të cilin vendim është detyruar që debitorit t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 236.61€ në emër të shpërblimit jubilar dhe atë për 14 vite të përvojës së punës.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorit lidhur me Vendimin e Inspektoratit të Punës përkatësisht se është lëshuar pa u vërtetuar gjendja faktike dhe erdhi në përfundim se një pretendim i tillë është pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit dhe përmbajtjes së tij, sepse i njëjti pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarrimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarrimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera te debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbarimore.

Andaj në kuptim të nenit 5 par. 5, neni 21, neni 22 par. 1, pika. 1.2, neni 23 par.2, neni 24 par. 3, 27.1, nenet 38, 69 paragrafi 4, si dhe nenet 71, dhe 73 paragrafi 3 të LPP-së, u vendos si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij **AKTVENDIMI**.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
PPP.nr.1000/21 , datë 31.01.2022**

Gj y q t a r i

Nehat Qelaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.